



Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë

Janar, 2019

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	2
Përmbledhje ekzekutive	3
Korniza ligjore dhe e politikave.....	5
Mekanizmat e koordinimit komunal për mbrojtjen nga dhuna në familje	9
Pasqyrim i sfidave.....	11
Konstatime	19
Rekomandime.....	20
Shtojca 1: Pasqyrë e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje në Kosovë	23
Shtojca 2: Pasqyrë e mekanizmave komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje	25

Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
DHBGJ	Dhuna në Baza Gjinore
DHF	Dhuna në familje
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GPNDHF	Grupin Punues Ndërmistror kundër Dhunës në Familje
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
KFOR	Forcat e Kosovës
LGBT	Lezbikë, Gej, Biseksualë, Transgjjinorë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum mirëkuptimi
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MV	Mbrojtës i Viktimave
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSV	Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje
QAP	Qendra e aftësimi profesional
QPS	Qendrat për Punë Sociale
SMC	Standardet Minimale të Cilësisë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKBGJ	Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore

Përmbledhje ekzekutive

Në vitin 2018, mbi 400 gra me fëmijë gjetën strehim në njërin nga 7 strehimoret funksionale¹ për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Mbi 1,100 raste të dhunës në familje, duke përfshirë shtatë persona që pësuan me vdekje, janë raportuar nga Policia e Kosovës në periudhën janar-shtator 2018 - rritje kjo prej më shumë se 13 për qind nga një vit më parë. Strehimoret për gratë viktime të dhunës në baza gjinore bëjnë të mundur që ato të largohen nga marrëdhëniet abuzive; për më tepër, ato gjithashtu luajnë rol vendimtar në rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave.

Ky raport përshkruan kuadrin ligjor dhe institucional² që rregullon ofrimin e shërbimeve të strehimit për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Raporti gjithashtu ofron një pasqyrim të mekanizmave komunalë për mbrojtjen nga dhuna në familje që ekzistojnë në tërë Kosovën. Bazuar në intervistat me drejtorët e të gjitha strehimoreve, të cilat janë realizuar nga qershori deri në gusht 2018, ky raport shtjellon procesin e licencimit, shërbimet e ofruara, kushtet e përgjithshme të strehimoreve dhe kapacitetet e tyre, skemën e financimit dhe rolin e bashkëpunimit ndërkomunal në ofrimin e mbështetjes financiare për disa prej këtyre strehimoreve. Raporti pastaj identifikon sfidat kryesore me të cilat përballen strehimoret për çdo ditë. Në veçanti, strehimoret kanë mungesë të financimit të qëndrueshëm, kryesisht për shkak të mungesës së dispozitave të qarta të institucioneve për financim. Gjithashtu, strehimoret kanë nevojë për mundësi më të mira trajnimi për stafin, auditime transparente publike, zgjidhje alternative për licencimin e stafit të cilët kredencialet e tyre i kanë fituar jashtë Kosovës, si dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet komunave. Në fund, raporti propozon rekomandime për të gjitha institucionet që marrin pjesë në mekanizmat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe për drejtorët e strehimoreve.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtutjeshëm OSBE) ka shtuar përpjekjet për të mbështetur agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera që adresojnë dhunën në familje. Raporti shihet si pjesë e reagimit të OSBE-së ndaj fenomenit të dhunës në familje në përputhje me mandatin e organizatës për monitorimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

¹ Tani, në Kosovë ekzistojnë tetë strehimore të dhunës në familje, nga të cilat shtatë janë funksionale. Shtatë strehimoret funksionale janë në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë Jugore. Strehimorja e tetë ndodhet në Novobërdë, dhe ende është në procedurë të licencimit.

² Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2010), Strategjia e Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (2013).

Hyrje

Strehimoret³ për viktimat e dhunës në familje janë shërbime të specializuara mbështetëse që mundësojnë mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave dhe janë treguar të jenë efektive në ndihmën që ju ofrojnë grave për t'u larguar nga marrëdhëniet abuzive. Në Kosovë, në periudhën janar-shtator 2018, në Policinë e Kosovës janë raportuar 1,129 raste të dhunës në familje, që paraqet rritje prej 148 rasteve për të njëjtën periudhë të vitit 2017.⁴ Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës raportoi 7 raste të vdekjeve si pasojë e dhunës në familje. Në të njëjtën kohë, në periudhën ndërmjet janarit dhe nëntorit 2018, mbi 400 gra me fëmijë, u strehuan në një nga 7 strehimoret funksionale për viktimat e dhunës në familje në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Prizren dhe Mitrovicë të Jugut; Strehimorja në Novobërdë ende nuk ishte funksionale në kohën e raportimit.⁵

Qëllimi i këtij raporti është që të paraqesë dhe analizojë kuadrin ligjor dhe institucional që rregullon tetë strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë, skemën e tyre aktuale të financimit, zhvillimin profesional të stafit, gamën e shërbimeve të ofruara për viktimat, dhe nivelin e bashkëpunimit në kuadër të mekanizmave komunalë për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ky raport gjithashtu synon t'i shpjegojë mekanizmat komunalë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe të përshkruajë situatën aktuale të strehimoreve, duke përfshirë procesin e licencimit, kapacitetet, financimin dhe bashkëpunimin me komunat. Për të ndihmuar në trajtimin e disa prej sfidave kryesore me të cilat përballen strehimoret, raporti ofron një sërë rekomandimesh për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Drejtësisë/koordinatorin e Kosovës kundër dhunës në familje, udhëheqësinë komunale dhe drejtorët e strehimoreve. Në fund të raportit janë paraqitur dy dokumente shtesë që japin hollësi mbi strehimoret e dhunës në familje në Kosovë dhe mekanizmat komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje. Për sa i përket metodologjisë, ky raport bazohet në rezultatet e vizitave në terren të kryera nga OSBE-ja në strehimoret e lartpërmendura⁶ ndërmjet qershorit dhe gushtit 2018 dhe hulumtimeve nga zyra e konsultimeve të gjera me palët e interesit në dhjetor 2018.

³ *Strehimorja* është vend i sigurt ku viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre u sigurohet strehim të përkohshëm, siguri, këshillim dhe shërbime të tjera. Shih faqen 10, *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në bazë të Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje*, Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, 2013.

⁴ Bazuar në statistikat e Policisë së Kosovës të disponueshme në kohën e raportimit, shumica e rasteve në vitin 2018 janë raportuar në rajonin e Prishtinës (332 raste), vijuar nga rajoni i Prizrenit (178 raste), Gjiilanit (146 raste), Ferizajt (140 raste) dhe Pejës (150 raste). Mbi 900 viktima i përkisnin komunitetit shqiptar, mbi 70 komunitetit serb, dhe rreth 30 ishin nga komuniteti rom dhe ashkali, përkatësisht. Në vitin 2017, në Policinë e Kosovës ishin raportuar 1,269 raste. Mesatarisht, në rreth 30 për qind të rasteve të raportuara, viktimat ishin burra.

⁵ Si krahasim, nga viti 2010 deri në vitin 2014, mesatarisht ishin 257 viktima të vendosura në strehimoret për viktimat e dhunës në familje, çdo vit. Shih *Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planin i Veprimit 2016-2020*, (Prishtinë, 2016), faqe 29.

⁶ Fusnota sipër 1. OSBE-ja vizitoi tetë strehimoret, që gjendeshin në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Prizren, Mitrovicë të Jugut dhe Novobërdë (e cila aktualisht nuk është funksionale për shkak të vonësve me procesin e licencimit).

Korniza ligjore dhe e politikave

Nuk ka legjislacion specifik për strehimin e viktimave të dhunës në familje në Kosovë. Sidoqoftë, licencimi i tyre, përgjegjësitë, financimi, mbikëqyrja, marrëdhënia me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, si dhe bashkëpunimi me palët tjera përkatëse, rregullohen me një varg të gjerë të dokumenteve ligjore. Këto dokumente mund të grupohen në dy kategori; e para i referohet legjislacionit që trajton drejtpërsëdrejti dhunën në familje; dhe e dyta, legjislacionit që rregullon funksionimin e organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale për personat në nevojë, përfshirë viktimat e dhunës në familje.

Në kategorinë e parë i referohemi Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje të miratuar në vitin 2010.⁷ Më vonë, në vitin 2013, "Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje" (në tekstin e mëtejme PSV)⁸ u nxorën nga Agjencia për Barazi Gjinore. PSV-të janë bazuar në "Programin e Kosovës dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014", i cili u përditësua në vitin 2016 me "Strategjinë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planin e Veprimit 2016-2020"⁹ (në tekstin e mëtejme Strategjia).

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ofron një gamë të gjerë masash mbrojtëse, duke përfshirë urdhrat e përkohshëm për mbrojtje emergjente, urdhrat për mbrojtje emergjente dhe urdhrat për mbrojtje¹⁰; megjithatë, nuk i është kushtuar vëmendje masave të rehabilitimit dhe riintegritimit dhe "strehimorja" përmendet vetëm një herë në kuadër të përgjegjësive të Policisë së Kosovës për të "siguruar transport për viktimën dhe sipas nevojës edhe vartësit e viktimës deri tek strehimorja apo vendstrehimi tjetër adekuat e i sigurt, me kërkesë të viktimës"¹¹.

Megjithatë, Agjencia për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, përmes PSV-së për mbrojtje nga dhuna në familje përmend mekanizmat institucionalë, duke cekur strehimoret si partnerë mbështetës joqeveritarë, të përfshirë drejtpërsëdrejti në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe shpjegon përgjegjësitë e tyre në katër fazat e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje, që janë: identifikimi; referimi; mbrojtja; riintegritimi dhe rehabilitimi. Sipas PSV-së, strehimoret luajnë rol kyç në mbrojtjen, riintegritimin e rehabilitimin e viktimave në shoqëri dhe, në këtë drejtim, ato

⁷ Ligji nr. 03/L -182 për Mbrojtjen nga dhuna në familje, 1 korrik 2010.

⁸ Fusnota sipër 3.

⁹ Fusnota sipër 5.

¹⁰ Shih nenet 18 dhe 22, *po aty*. Urdhri i përkohshëm për mbrojtje emergjente: urdhër i lëshuar nga policia jashtë orarit të punës të gjykatave; urdhër për mbrojtje emergjente: urdhër i lëshuar përkohësisht me vendimin gjyqësor (deri në 8 ditë); urdhër për mbrojtje: urdhër i lëshuar me vendim gjyqësor që siguron masa mbrojtëse për viktimën (deri në 12 muaj).

¹¹ Shih neni 24, paragrafi 3.6. *Po aty*.

sigurojnë vend të sigurt në çdo kohë për viktimat e dhunës në familje dhe ofrojnë shërbime tjera si veshmbathje; ushqim; shërbime shëndetësore dhe medikamente; këshillim dhe trajtim psikosocial; këshillim juridik; trajtim special për viktimat me nevoja të veçanta (si "viktima të ndjeshme")¹²; hapësira të posaçme për rehabilitimin e viktimave dhe aktivitete të ndryshme.¹³ Pas pranimit, gjatë 48 orëve të para, strehimoret zbatojnë "periudhën e reflektimit" për viktimat e sapo referuara. Kjo nënkupton qasje të menjëhershme në akomodim të sigurt, për të ofruar siguri të pandërprerë fizike nga kryerësi. Në një fazë të mëvonshme, çdo strehimore pritet të caktojë menaxherin e rastit brenda një strehimoreje i cili, në bashkërendim me një punonjës të Qendrës për Punë Sociale (QPS), zhvillon plan individual të riintegrit, që përfshin edhe trajnimin që synon zhvillim profesional të viktimave për të lehtësuar mundësitë e tyre të punësimit dhe riintegrimin në shoqëri. Në këtë drejtim, strehimoret luajnë rol vendimtar në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të viktimës.

Strategjia shërben si "udhërrëfyes për përpjekjet (e institucioneve dhe tërë shoqërisë) për të zvogëluar fenomenin e dhunës në familje"¹⁴. Strategjia përcakton katër objektiva strategjike për t'u përmbushur deri në vitin 2020 dhe zbatimi i këtyre objektivave është planifikuar në katër shtylla: parandalimi dhe vetëdijesimi; mbrojtja dhe koordinimi; legjislacioni, hetimi dhe procedimi gjyqësor; dhe rehabilitimi dhe riintegrimi. Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë 2016-2020, shumica e aktiviteteve të planifikuara që përfshijnë strehimoret janë përfshirë në shtyllën e katërt të rehabilitimit dhe riintegrit dhe përfshijnë, ndër të tjera, sigurimin e strehimit afatgjatë për viktimat përmes marrëveshjeve ndërkomunale; krijimin e strehimoreve të reja që do të adresonin nevojat e komuniteteve pakicë; hapjen e strehimoreve për burrat të cilët janë viktima të dhunës në familje; trajnimin e personelit të strehimoreve në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore për të gjitha kategoritë e viktimave të dhunës në familje (si individë lezbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transeksualë (LGBT) dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë) dhe sigurimin e mbështetjes së strehimoreve nga institucionet lokale në baza të rregullta vjetore.¹⁵

¹² Sipas PSV, viktimë e ndjeshme është "fëmija, personi me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, personi me aftësi të kufizuara, gruaja shtatzënë ose partneri në familje". Siç është elaboruar nga drejtori i strehimoreve në Prishtinë, shumë strehimoreve u mungon stafi i kualifikuar dhe fondet për të ofruar kujdes më të mirë për këtë kategori të veçantë të viktimave.

¹³ Shihni faqen 41, Fusnota *Sipër* 3.

¹⁴ Shihni faqen 37, Fusnota *sipër* 5.

¹⁵ Shih, *Plani i Veprimit në Strategjinë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020*, Shtylla e katërt, (Prishtinë), Ministria e Drejtësisë 2016. Zbatimi i strategjisë mbikëqyret nga zëvendësministri i drejtësisë, i cili shërben si koordinator i Kosovës kundër dhunës në familje (Koordinator) dhe në këtë cilësi koordinon grupin koordinues ndërmintor kundër dhunës në familje (GPNMDHF). GPNMDHF përbëhet nga përfaqësuesit e nivelit politik dhe operativ, duke përfshirë zëvendësministrit e ministrive përkatëse dhe personat kontaktues të dhunës në familje (DhF), Koalicioni i Strehimoreve në Kosovë dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare. Mandati i grupit është që të takohet çdo muaj me qëllim të koordinimit të të gjitha aktiviteteve të lidhura me DhF në nivel qendror; që të vlerësoj dhe diskutoj trendet, zhvillimet dhe sfidat e reja në luftën kundër DhF; të rris përpjekjet e përbashkëta dhe të forcoj mbështetjen politike drejt eliminimit të DhF.

Ndërsa legjislacioni dhe korniza e politikave të lartpërmendura përshkruajnë detyrat e strehimoreve dhe i vendosin në mesin e mekanizmave tjerë që trajtojnë dhunën në familje, ka ligje të veçanta (që kategorizohen nën grupin e dytë), që rregullojnë licencimin, financimin dhe mbikëqyrjen e strehimoreve. Në përputhje me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përgjegjësi të përgjithshme për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, të ofruara edhe nga organizatat joqeveritare (OJQ), duke përfshirë strehimoret.¹⁶ Ndonëse komunat dhe organizatat joqeveritare mund të ofrojnë shërbime sociale, MPMS rezervon të drejtën për të përcaktuar se si do të realizohen këto shërbime.

Për më tepër, MPMS, në përputhje me ligjin për shërbimet sociale dhe familjare, përmes Departamentit të Mirëqenies Sociale, është përgjegjëse për licencimin e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, kryerjen e inspektimeve të këtyre shërbimeve dhe miratimin e themelimit të qendrave rezidenciale për përkujdesje.¹⁷ Procesi i licencimit të OJQ-ve është zhvilluar edhe më tutje përmes Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Organizatave Joqeveritare¹⁸. Për sa i përket licencimit të profesionistëve që punojnë në shërbimet familjare dhe sociale, ky proces kryhet nga Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (Këshilli) i përbërë nga 21 profesionistë që punojnë në fushën e shërbimeve sociale, përfaqësues të komunave, OJQ, grupe akademike dhe të tjerë të emëruar nga MPMS-ja. Këshilli është përgjegjës për të siguruar licencimin, regjistrimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të praktikuesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Gjithashtu, ai pranon, mbledh dhe trajton rastet e pretendimeve për sjellje të pahijshme të këtyre profesionistëve dhe vendos për sanksionet që duhen zbatuar.¹⁹ Për më tepër, procedurat e licencimit të anëtarëve të stafit të OJQ-ve janë zgjeruar dhe specifikohen më tej në Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Zyrtarëve Socialë.²⁰

Përkundër faktit se ekziston një kornizë solide ligjore dhe institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale, nuk ka dispozita specifike që përcaktojnë se cilat shërbime sociale duhet të ofrohen nga komunat, gjë që rezulton me situatën ku fondet për shërbimet sociale, veçanërisht për strehimore për viktimat të dhunës në familje, shpërndahen përmes institucioneve qeveritare dhe lokale. Për shkak të procesit të decentralizimit në vitin 2009, MPMS-ja transferoi përgjegjësitë e ofrimit të shërbimeve sociale tek

¹⁶ Shih nenet 12.2 dhe 2 (paragrafi 1 dhe 3) të ligjit nr. 02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare, 21 prill 2005 dhe ndryshimet e plotësimet me ligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare, 2 mars 2012.

¹⁷ Shih nenin 3, po aty

¹⁸ Shih *Udhëzimin Administrativ 17/2013 për licencimin e personave juridikë/organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare*, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 31 dhjetor 2013.

¹⁹ Shih nenin 5, paragrafi 29, Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, Fusnota sipër 16.

²⁰ Shih *Udhëzimin Administrativ nr.13/2013 për licencimin e ofruesve të shërbimeve familjare dhe sociale*, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 5 dhjetor 2013.

komunat, duke ruajtur të drejtën për dhënien e granteve për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në mbarë Kosovën. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare përcakton që për të mundësuar që komunat ose OJQ-të të ofrojnë shërbime sociale në nivel lokal, MPMS-ja do të ndajë fonde vjetore nga buxheti i saj, që vlerësohet të arrijë mbi 460 milionë euro në vitin 2019²¹, për këtë qëllim përmes njoftimit publik të blerjes së shërbimeve²². I njëjti ligj përcakton se institucionet vendore, përmes drejtorive përkatëse, janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe prodhimin e planeve vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e atyre brenda territorit të tyre.²³ Ligji për vetëqeverisjen lokale e forcon pozitën e komunave duke shtuar se ato “kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, si kujdesi për kategoritë e ndjeshme”²⁴, dhe, siç është cekur në Ligjin për financat e pushtetit lokal, “komunat kanë të drejtë të pranojnë grant të përgjithshëm që mund të përdoret për zbatimin e ndonjëres prej kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet në fuqi të Kosovës”²⁵. Sidoqoftë, gjersa granti i përgjithshëm lëshohet në baza vjetore, nuk ka dispozita specifike lidhur me ndarjen e tij për shërbime sociale. Kjo mungesë e qartësisë midis komunave rreth buxhetit lokal të disponueshëm për shërbimet sociale, çon në ndryshueshmëri të nivelit të mbështetjes për ofrimin e shërbimeve sociale.²⁶ Në të njëjtën kohë, komunave u lejohej të lidhin kontrata me OJQ-të për ofrimin e shërbimeve specifike sociale dhe familjare brenda territorit të tyre, si dhe të “bashkëpunojnë dhe formojnë partneritete me komunat tjera brenda fushave të tyre të kompetencave (...).”²⁷

²¹ Bazuar në Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2019. Projektbuxheti për MPMS-në në vitin 2019 është planifikuar të rritet në krahasim me vitin 2018, nga 408,741,593 euro në 465,809,402 euro, duke qenë buxheti më i madh në mesin e ministrive të Kosovës dhe institucioneve të tjera qeveritare.

²² Shih nenin 2, paragrafi 10, Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, Fusnota sipër 16.

²³ Shih nenin 6, po aty

²⁴ Shih nenin 17, paragrafi 1(k), ligji nr. 03 / L-040 për vetëqeverisjen lokale, 20 shkurt 2008.

²⁵ Shih nenin 24, paragrafi 1, ligji nr. 03/L- 049 për financimin e pushtetit lokal, 13 mars 2008 me ndryshimet e tij në ligjin nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-049 për financimin e pushtetit lokal, 14 korrik 2016.

²⁶ Shih Qendra Evropiane për Politikë dhe Hulumtim të Mirëqenies Sociale, *Analiza e Situatës. Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë*, Prishtinë dhe Vjenë, 2018, f. 7, 19, 24-26.

²⁷ Shih nenin 28, Ligji për vetëqeverisje lokale, Fusnota sipër.24.

Mekanizmat e koordinimit komunal për mbrojtjen nga dhuna në familje

Në vitin 2013 u miratuan PSV-të për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje me qëllim të "krijimit të një sistemi të koordinuar në të gjitha institucionet e Kosovës me qëllim të reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në rastet e dhunës në familje për ofrimin e asistencës dhe mbështetjes cilësore për viktimat e dhunës në familje". Ky sistem i koordinuar është i përbërë, ndër të tjera, nga përfaqësues të Policisë së Kosovës, gjyqtarë, prokurorë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, Ministria e Drejtësisë, MPMS, QPS, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizata të shoqërisë civile dhe strehimore si partnerë mbështetës joqeveritarë.

Në nivel lokal, Strategjia parasheh krijimin e mekanizmave të bashkërendimit komunal për mbrojtjen nga dhuna në familje. Këto mekanizma janë organe komunale që pasqyrojnë përbërjen e institucioneve të nivelit qendror në nivel komunal me qëllim të përmirësimit të ndihmës që u ofrohet viktimave të dhunës në familje, lehtësimit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rritjes së koordinimit ndërmjet palëve të interesuara në çështjet e dhunës në familje.²⁸ Mekanizmat mbështesin strehimoret për të trajtuar më mirë rastet e dhunës në familje, duke siguruar qasje të shpejtë në shërbimet e disponueshme për viktimat, shërbejnë si platformë për avokim në mënyrë që të marrin mjete financiare nga komunat përkatëse dhe mbështesin përfshirjen e të mbijetuarve të dhunës në baza gjinore në programet e banimit social.

Deri në dhjetor 2018, janë krijuar gjithsej 17 mekanizma komunalë të koordinimit, duke përfshirë të gjitha komunat ku ndodheshin tetë strehimoret (Shtojca 2). Nga këta 17 mekanizma komunalë, 15 komuna²⁹ nënshkruan MM formale me aktorët përkatës komunalë, përfshirë kryetarët e komunave, Policinë e Kosovës, mbrojtësit e viktimave, prokuroritë themelore, gjykatat themelore, departamentet komunale të arsimit dhe shëndetësisë, njësitë e të drejtave të njeriut, shërbimin korrektues, qendrat e aftësisë profesionale, zyrat e punësimit, zyrat për ndihmë juridike falas, qendrat për punë sociale dhe strehimoret.³⁰

Duke iu referuar mekanizmave komunalë të themeluara në komunat që kanë strehimore për viktimat e dhunës në familje, i pari është krijuar në vitin 2008 në

²⁸ Shënim sipër 14, faqe 24.

²⁹ Gjakovë, Gjiçan, Dragash, Lipjan, Prizren, Glogoc, Skenderaj, Viti, Ferizaj, Obiliq, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Han i Elezit.

³⁰ Komuna e fundit që nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit në dhjetor 2018 ishte Hani i Elezit, ndërsa komuna e Prishtinës, ndonëse kishte një strehimore, nuk kishte memorandum mirëkuptimi formal me autoritetet lokale në kohën e raportimit.

komunën e Gjakovës me mbështetjen e OSBE-së. Mekanizmat komunal funksionojnë edhe në Gjilan, Pejë, Prizren dhe Ferizaj.³¹ Mekanizmat në Prishtinë dhe në Mitrovicën e Jugut janë themeluar por nuk janë aktive, për shkak të mungesës së fondeve për organizimin e takimeve të rregullta dhe mbështetjes së pamjaftueshme nga institucionet vendore

Me përkrahjen e OSBE-së Mekanizmat komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje janë themeluar edhe në komunat që nuk ka strehimore për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë komunat si Lipjani, Klina, Glllogovci, Skënderaj, Vitia dhe Obiliqi; por edhe në Dragash, Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, me përkrahje nga UN Women. Në kohën e shkrimit, Koordinatori i Kosovës për Dhunën në Familje/zëvendësministri i drejtësisë (Koordinatori) ka planifikuar themelimin apo rifunksionalizimin e mekanizmave koordinues komunalë në Graçanicë dhe Shtërpçë me përkrahjen e OSBE-së; në Mitrovicë të Jugut dhe Podujevë, me përkrahjen nga UN Women; si dhe në Suharekë, Rahovec dhe Malishevë, në bazë të nismës vetanake të Koordinatorit.³²

Nivelet e funksionimit të mekanizmave dallojnë përgjatë gjithë Kosovës, ku 10³³ nga 17 mekanizmat funksionojnë plotësisht si dhe mbajnë takime të rregullta mujore e tremujore, katër³⁴ që funksionojnë pjesërisht dhe dy³⁵ që nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje³⁶. Kryesimi i mbledhjeve i jepet kryesisht zyrtarit komunal për barazi gjinore (ZKBGJ), ose ndahet ndërmjet ZKBGJ-së dhe drejtores së strehimores³⁷; zyrtarit komunal³⁸; ose një përfaqësuesi të QPS-së³⁹. Komunat shpesh ofrojnë përkrahje logjistike për organizimin e mbledhjeve. Në Gjakovë, Dragash e Pejë, institucionet lokale gjithashtu ofrojnë përkrahje modeste financiare për ndërmarrjen e aktiviteteve promovuese në lidhje me mbrojtjen nga dhuna në familje.

Suksesi i këtyre mekanizmave është i lidhur fuqimisht me vullnetin politik të udhëheqësisë komunale, angazhimin aktiv dhe interesimin e anëtarëve dhe mbështetjen nga bashkësia ndërkombëtare. Mungesa e mbështetjes financiare, kombinuar me mungesën e mbledhjeve të rregullta për bashkëpunim e këmbim të informatave, pengojnë funksionimin efektiv të mekanizmave.

³¹ E themeluar me përkrahje nga OSBE, UN Women dhe BE. Shih shtojcën 2 të këtij raporti.

³² Bazuar në takimin ndërmjet Koordinatorit, UN Women dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, mbajtur më 21 qershor 2018.

³³ Gjakovë, Dragash, Lipjan, Pejë, Ferizaj, Obiliq, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, Skënderaj.

³⁴ Gjilan, Glllogoc, Pejë dhe Prizren.

³⁵ Prishtinë dhe Viti.

³⁶ Shih Shtojcën 2 të këtij Raporti për më shumë hollësi për takimet e mbajtura gjatë periudhës së raportimit.

³⁷ Gjilan, Skënderaj, Gjakovë, Pejë, Prizren, Dragash, Obiliq dhe Prishtinë.

³⁸ Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

³⁹ Glllogoc dhe Lipjan.

Pasqyrim i sfidave

Gjendja në terren përbëhet nga një mori sfidash⁴⁰. Mungesa e legjislacionit të harmonizuar dhe buxhetit të dedikuar janë sfidat më themelore me të cilat përballen strehimoret. Qëndrueshmëria e tyre shpesh varet nga përkrahja financiare *ad hok* nga komunat, donatorët ndërkombëtarë, apo projektet e krijimit të të ardhurave. Përveç kësaj, edhe pse stafi i strehimoreve është përgjithësisht dygjuhësh, viktimat që nuk flasin shqip ende nuk kanë qasje për shkak se informatat themelore për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje nuk ofrohen edhe në të dy gjuhët zyrtare. Gjithashtu, mundësitë e arsimimit për viktimat, por edhe zhvillimit profesional për stafin e strehimoreve janë aktualisht të pamjaftueshme. Njëkohësisht, edukimi brenda strehimores së mbyllur për fëmijët e vendosur aty ngre brengat lidhur me riviktimizimin e fëmijëve. Strehimoret e udhëhequra nga serbët e Kosovës gjithashtu përballen me probleme licencimi, sepse institucionet e Kosovës nuk njohin disa prej diplomave e certifikatave të tyre.

Procesi i licencimit

Siç parashihet me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare dhe ndryshimet e plotësimet e tij, procesi i licencimit të strehimoreve udhëhiqet nga MPMS-ja çdo tri vjet. Ky proces kërkon nga strehimoret që të dëshmojnë, *ndër të tjera*, që kanë të angazhuar së paku dy punëtorë socialë me orar të plotë nga katër profilet e caktuara (sociolog, psikolog, punëtor social dhe jurist), që ajo të plotësojë kriteret e sigurisë dhe rendit⁴¹, si dhe të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e pritura. Pas përfundimit të procesit të licencimit për stafin e strehimoreve, që në shkallë të parë kërkon verifikimin e diplomave të tyre, ajo qendër mund të aplikojë për licencë të strehimores. Procesi i parë merr dy muaj; ky i fundit merr një muaj.⁴²

Ekzistojnë shtatë strehimore të licencuara për viktimat e dhunës në familje në Kosovë dhe një që aktualisht është në proces të licencimit. Të parat janë themeluar në Gjilan (1999), Prishtinë (2000), Pejë (2001), Gjakovë (2002) dhe Prizren (2002) si dhe të fundit janë themeluar në Mitrovicë të Jugut (2007), Ferizaj (2014) dhe Novobërdë (2018). Strehimorja në Novobërdë është strehimorja e parë që udhëhiqet nga komuniteti serb i Kosovës; megjithatë, për shkak të procesit të licencimit në vazhdim e sipër, nuk është ende në funksion. Strehimorja ka vështirësi të gjejë punëtorë socialë me diploma që njihen nga institucionet e Kosovës. Siç është raportuar nga drejtori i strehimores,

⁴⁰ Shih Shtojcën 1 "Pasqyrë e strehimoreve të dhunës në familje në Kosovë".

⁴¹ P.sh. instalimi i kamerave vëzhguese.

⁴² Procesi i licencimit për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare dhe stafit të tyre bazohet tek Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, 21 prill 2005 (neni 5) dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime sociale dhe familjare, 2 mars 2012 (neni 3.5 dhe neni 5) por edhe Udhëzimi Administrativ MPMS 17/2013 për Licencimin e subjekteve juridike/organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare si dhe Udhëzimi Administrativ MPMS nr. 13/2013 për Licencimin e ofruesve të shërbimeve familjare dhe sociale.

shumica e punëtorëve socialë serbë të Kosovës kanë marrë kredencialet e tyre profesionale në sistemin serb, si dhe tash kanë probleme të nostrifikimit të diplomave. Për t'u kualifikuar, kandidati duhet të ketë diplomë të marrë para vitit 1999 ose diplomë të fituar nga Universiteti në Mitrovicë të Veriut në gjuhën serbe. Aktualisht, strehimorja më e afërt për shërbime për banorët e komunave Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok⁴³ gjendet në Mitrovicë të Jugut. Rrjedhimisht, pasi që nuk ka strehimore të udhëhequr nga komuniteti serb në Kosovë, komunat me shumicë numerike të komunitetit serb nuk janë pjesë e asnjë mekanizmi ndërkomunal bashkëpunues për përkrahjen e shtatë strehimoreve funksionale. Kjo mund të ndryshojë pasi strehimorja në Novobërdë të licencohet dhe të jetë plotësisht funksionale.

Referimi për strehimore dhe pengesat gjuhësore

Referimi për strehimore zakonisht bëhet nga QPS-ja, por mund të bëhet edhe nga policia apo institucionet tjera, me kërkesë të viktimës; edhe personat që kanë përjetuar dhunë mund të vetë-referohen.⁴⁴ Siç është theksuar në PSV-të për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, referimi dhe ofrimi i ndihmës për viktimat e dhunës në familje duhet të bëhen pa diskriminim në baza të gjinisë, seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik a tjetër, prejardhjes sociale apo kombësisë, pronës, lindjes apo ndonjë statusi tjetër.⁴⁵ Megjithatë, në praktikë, edhe pse shumë të punësuar në strehimore janë të rrjedhshëm në të dyja gjuhët zyrtare të Kosovës, shqip dhe serbisht⁴⁶, strehimoret nuk ofrojnë informata në gjuhë të tjera përveç shqipes, duke kufizuar kështu qasjen për ata që nuk flasin shqip. Në rastin e komunave veriore, viktimat e dhunës në familje preferojnë të qëndrojnë në stacionin lokal policor, spital, apo tek miqtë e të afërmit, në vend se të shkojnë tek strehimorja më e afërt në Mitrovicën e Jugut, për shkak të perceptimeve të sigurisë dhe barrierave gjuhësore. Për më tepër, derisa në strehimore mund të qëndrojnë djem deri në 12 vjeç, nëse janë nën përcjelljen e nënës, nuk ka ndonjë qasje sistemore për ofrimin e kujdesit për djem që janë më të rritur sesa 12 vjeç.⁴⁷ Përveç kësaj, nuk ka strehimore për burra në Kosovë, në veçanti për më të moshuarit që gjithashtu i nënshtrohen dhunës në familje – që kryesisht nuk kryhet nga

⁴³ Në maj të vitit 2016, zyra administrative e Qeverisë Serbe në komunën e Mitrovicës së Veriut deklaroi hapjen e strehimores në Mitrovicë të Veriut dhe një shtëpi në Mëhallën e Boshnjakëve ishte ndarë për këtë qëllim; megjithatë, që prej atëherë, nuk janë bërë hapa të mëtutjeshëm për ta përfunduar projektin.

⁴⁴ Shih faqen 22 të Strategjisë, fusnota sipër 5.

⁴⁵ Shih faqen 24 të PSV-së, fusnota sipër 3.

⁴⁶ Shih nenin 1, Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

⁴⁷ Sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës, Kosova do të duhej që të "(...) ofronte tranzicionin e mjaftueshëm dhe/ose mundësitë e qëndrimit të përhershëm për viktimat, si dhe të siguronte qasje në akomodim të sigurt për gra me djem mbi 12 vjeç." Shih: Këshilli i Evropës, *Identifikimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, (Prishtinë, 2017), f. 77. Njëkohësisht, një numër OJQ-sh ofrojnë pak përkrahje për djemtë mbi moshën 18-vjeçare, e që janë viktimat keqtrajtimi; për shembull, OJQ "Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijë" (në anglisht: Hope and Houses for Children), me seli në Prishtinë, ka për mandat që të strehojë ata fëmijë, nënat e të cilëve janë të vendosura në strehimore për viktimat e dhunës në familje. Në Pejë, Qendra Sprovuese për Rini bashkëpunon me OJQ-në "Operation Restoration", tri shkolla lokale dhe QPS-në për të mbështetur rastet më të cenushme të të rinjve, disa prej të cilëve janë edhe viktimat e dhunës në familje.

bashkëshortët e tyre, por nga anëtarët tjerë të familjes përfshirë baballarët, djemtë dhe vëllezërit.⁴⁸

Kushtet e përgjithshme në strehimore

Mesatarisht, strehimoret kanë mes pesë dhe tetë pjesëtarë stafi me orar të plotë, duke përfshirë psikologët, mësuesit, këshilltarët dhe ndërmjet një dhe katër të punësuar me gjysmë orari, të cilët ndihmojnë strehimoret në administratë financa, shërbime mjekësore dhe trajnime. Kushtet e përgjithshme të të gjitha strehimoreve të vizituara ishin të mira ose tejet të mira dhe të gjitha ofrojnë shërbimet e përmendura në PSV-në për mbrojtje nga dhuna në familje. I vetmi dallim i vërejtur mes strehimoreve ishte në spektrin e trajnimeve dhe aktiviteteve që ofrohen për klientët e tyre. Për shembull, strehimorja në Gjakovë ofron kurse që shkojnë nga gjuha bazike angleze e deri tek kompjuterët, prodhon mjaltin e vet dhe pjek e shet bukën e vet. Strehimoret tjera, si për shembull ato në Prishtinë, Prizren e Mitrovicë të Jugut, kanë zhvilluar aftësi profesionale në floktari, kozmetikë, rrobaqepësi dhe/ose gatim, por nuk shesin shërbime apo produkte të vetat.

Shumica e strehimoreve janë gjysmë të hapura, gjë që i lejon fëmijëve të viktimave të ndjekin shkollën dhe viktimave të angazhohen në aftësim profesional, apo edhe të gjejnë punë me gjysmë orari, së kujdesin për të moshuar apo pastrimin e banesave jashtë hapësirave të strehimores. Në rastet e strehimoreve gjysmë të hapura, ku fëmijët mund të vijojnë shkollat publike, është më sfiduese të mundësohen orë mësimi për fëmijët që vijojnë planprogramin e Serbisë, mes tjerash, për shkak të kostos shtesë të transportimit.⁴⁹

Megjithatë, strehimoret e mbyllura, për shkak të gjendjes së rënduar të sigurisë, nuk i lejojnë klientët e tyre të largohen nga hapësirat e strehimores, përveç me përcjellje nga personeli i strehimores dhe/ose Njësia e Policisë së Kosovës për Dhunën në Familje, ndërsa shkollimi dhe trajnimet merren përbrenda strehimores (Ferizaj dhe Prishtinë). Ekzistojnë edhe disa qëndrime që strehimoret e mbyllura ndikojnë negativisht tek zhvillimi i fëmijëve, duke çuar në riviktimizimin e tyre. Kjo mund të rezultojë me situatën ku disa viktima me fëmijë refuzojnë të shkojnë në strehimore të mbyllura, sepse duan që fëmijët e tyre të vazhdojnë shkollimin, ndonëse strehimoret e tipit të mbyllur ofrojnë mësim private në strehimore, të mundësuar nga Ministria e Arsimit.⁵⁰

⁴⁸ Sipas raportit të publikuar së voni nga OSBE dhe UNFPA, rreth 12 për qind të djemve nën moshën 18-vjeçare janë kërcënuar ndonjëherë me dënime fizike në shtëpitë e tyre, ndërsa katër për qind kanë raportuar që kjo sjellje ndodh shpesh. Shih: Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNFPA, *Perspektiva e burrave ndaj barazisë gjinore në Kosovë*, (Prishtinë, 2018), f. 27.

⁴⁹ Këto gjetje bazohen në tryezën e rumbullakët të mundësuar nga OSBE-ja mbi "Vazhdimësinë e shkollimit për fëmijët viktima të dhunës në familje", mbajtur më 27 nëntor 2018 në Gjilan.

⁵⁰ Po aty.

Pronësia dhe kapacitetet e strehimoreve

Ka dallime në aspektin e pronësisë së objekteve të strehimoreve. Në komunat Novobërdë, Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë, objektet ku janë vendosur strehimoret janë dhuruar nga komunat përkatëse, derisa strehimoret tjera në Ferizaj dhe Mitrovicë të Jugut paguajnë qira mujore që shkon nga 250 deri në 450 euro, respektivisht⁵¹. Rrjedhimisht, prioriteti numër një për strehimoren në Mitrovicë të Jugut, që mban me qira objektin e një pronari privat, është të sigurojë objekt nga komuna dhe të lirohet nga qiraja mujore. Megjithatë, sipas drejtores së strehimoreve në Mitrovicë të Jugut, pas dërgimit të shumë kërkesave për objekt në komunë me muaj të tërë, ajo pretendon që ende nuk ka gjetur lokacionin adekuat.

Mesatarisht, strehimoret mund të strehojnë 15 persona (bashkë me fëmijët), por shumica ofrojnë edhe shtretër shtesë për situata emergjente. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit është gjashtë muaj; megjithatë, nëse vlerësimi i sigurisë nuk është i kënaqshëm, si dhe viktimat nuk ka vend tjetër ku të shkojë, ato mund të transferohen në strehimore tjetër, ose të mbeten në strehimoren e njëjtë edhe përtej periudhës gjashtëmujore në bazë të marrëveshjes paraprake me MPMS-në.⁵²

Mes janarit dhe nëntorit 2018, më se 400 gra me fëmijë kanë gjetur strehim në njërin prej shtatë strehimoreve funksionale në Kosovë.⁵³ Shumica dërmuese e viktimave i përkasin komunitetit shqiptar, ndërsa disa janë të komunitetit ashkali, egjiptian, rom dhe boshnjak të Kosovës. Nuk është raportuar asnjë viktimë nga komuniteti serb i Kosovës, në asnjërin prej strehimoreve. Në rastet e Mitrovicës së Jugut dhe Gjakovës, ka pasur rritje prej 10 për qind në numrin e viktimave të strehuara në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që sipas drejtores në Gjakovë, ka të bëjë me besimin në rritje tek shërbimet e strehimoreve. Për krahasim, mes viteve 2010 dhe 2014, mesatarisht rreth 257 viktimat kanë kërkuar strehim në këto strehimore brenda një viti.⁵⁴

Financimi i strehimoreve dhe bashkëpunimi ndërkomunal

Mungesa e financimit të qëndrueshëm për strehimoret përbën sfidën kryesore të operimit të tyre të përditshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për viktimat e dhunës në familje. Përkundër faktit që Departamenti i Mirëqenies Sociale brenda MPMS-së mban përgjegjësinë parësore për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të strehimoreve⁵⁵, ai financon vetëm rreth gjysmën e buxhetit të nevojshëm; fondet tjera sigurohen nga komunat dhe/ose donatorët ndërkombëtarë. Aktualisht, MPMS-ja mbështet strehimoret

⁵¹ Në bazë të intervistës së OSBE-së me drejtoren e strehimoreve në Mitrovicë të Jugut, mbajtur më 14 gusht 2018.

⁵² Sipas *Rregullores për strehimoret për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës tjetër*, viktimat qëndrojnë në strehimore për tri deri në katër vjet apo edhe më shumë (raste të tilla i ka parë OSBE-ja në Prizren dhe Gjakovë, gjatë këtij vlerësimi).

⁵³ Shtatëdhjetë e dy viktimat të strehuara në Gjakovë, 75 në Gjilan, 37 në Prizren, 49 në Prishtinë, 60 në Mitrovicë të Jugut, 61 në Pejë dhe 70 në Ferizaj.

⁵⁴ Shih faqen 29 të Strategjisë, fusnota sipër 5.

⁵⁵ Shih nenin 3.3, Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, fusnota sipër 16.

në baza vjetore.⁵⁶ Në vitin 2018, për shkak të vonesës së gjatë në ndarje të fondeve, si dhe vonesave në shpalljen e thirrjes për aplikim për grante të MPMS-së në shkurt të vitit 2018, ka pasur së paku boshllëk prej tre muajsh, gjatë të cilit strehimoret nuk kanë marrë kurrfarë fondesh. Si pasojë, mes janarit dhe shkurtit 2018, strehimoret në Pejë dhe Mitrovicë të Jugut, që nuk kishin as kursime e as mbështetje nga komuna apo donatorët ndërkombëtarë, u detyruan të nxjerrin jashtë të strehuarat. Strehimoret tjera, si ajo në Ferizaj, arritën të mbijetojnë për shkak të kursimeve dhe vazhduan të ofrojnë të gjitha shërbimet për viktimat tashmë të vendosura në strehimore, apo ato të referuara nga policia apo QPS-ja. Strehimorja në Gjakovë arriti të mbulonte disa prej shpenzimeve me të ardhura nga prodhimtaria e tyre (bukë, mjaltë) dhe vazhdoi funksionimin e saj, derisa strehimorja në Gjilan nuk u mbyll gjatë asaj periudhe, por refuzonte të ardhurit që nuk referoheshin nga Policia e Kosovës.⁵⁷

Pjesët e fondeve nga MPMS-ja dhe donatorët ndërkombëtar dhe nivelet e bashkëpunimit ndërkomunal dallojnë varësisht nga strehimorja. Në vitin 2018, strehimorja në Pejë, përveç 20.000 eurove nga MPMS-ja, përfitoi 6,500 euro që u bashkëfinancuan nga kryetarët e komunave Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale⁵⁸. Këto komuna ofrojnë financim në përpjesëtim me popullsinë e tyre; në këmbim, strehimorja jep përgjegjësi duke hartuar raport financiar për shpenzimet e veta çdo vit, në mënyrë që të kërkohet llogari për shpenzimet e bëra nga strehimorja. Në pajtim me ndarjet buxhetore të vitit 2018, komuna e Pejës kishte financuar 3.000 euro dhe ishte zotuar të punojë për rritjen e kësaj shume; komuna e Istogut ndau 1.500 Euro; ndërsa komuna e Deçanit rriti ndarjen e fondeve nga shuma e paraparë prej 1.500 euro në 2.000 euro. Përfundimet e vetme qenë komunat e Klinës dhe Junikut, që kishin deklaruar në Memorandum ndarjen prej 1.500, respektivisht 200 Euro, por që nuk dhanë ato fonde për strehimoren deri në datën 29 nëntor 2018.

Strehimorja në Mitrovicën e Jugut gjithashtu kishte marrë mbështetje nga MPMS në shumë prej 20.000 Eurosh dhe është shembull tjetër i strehimores që përfiton nga bashkëpunimi ndërkomunal. Në gusht të vitit 2018, drejtorja e strehimores nënshkroi memorandum mirëkuptimi me kryetarët e komunave Mitrovicë e Jugut, Vushtrri dhe Skënderaj, për të siguruar mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve operacionale për vitin 2018 dhe 2019. Si në rastin e Pejës, përpjesëtimi i shpenzimeve lidhet me popullsinë e komunave përkatëse dhe përfaqësohet në këto shifra: komuna e Mitrovicës së Jugut (3.390 Euro), komuna e Vushtrrisë (3.208 Euro) dhe komuna e

⁵⁶ Në qershor të vitit 2016, strehimoret e viktimave të dhunës në familje dërguan tek qeveria një plan buxhetor, të projektuar për të mbuluar shpenzimet në bazë të pakos së shërbimeve të strehimoreve. Në bazë të këtij plani të propozuar buxhetor, të gjitha strehimoret kanë kalkuluar që buxheti i nevojshëm vjetor është 60.000 Euro për strehimore, ku përfshihen shpenzimet për barna, ushqim, veshmbathje, mirëmbajtje të objektit, transport, komunikime, pagat e personelit, e kështu me radhë.

⁵⁷ Bazuar në informatat e dhëna nga drejtorët e strehimoreve gjatë intervistës.

⁵⁸ Shih nenin 17.1 (k), Ligji për vetëqeverisjen lokale, fusnota sipër 24.

Skënderajt (2.567 Euro). E njëjta formulë e kostove do të përdoret edhe në vitin 2019. Strehimorja është e obliguar të raportojnë mbi shpenzimet që mbulohen nga komunat në baza mujore.

Strehimoret tjera nuk gëzojnë mbështetje të rregullt financiare nga komunat. Në Gjilan, gjysma e buxhetit të strehimores sigurohet nga MPMS-ja, me gjithsej 20.000 Euro, përtej shumës prej 15.000 eurosh nga OJQ-ja "Save the Children", si dhe 5.000 Euro nga komuna e Gjilanit, por nuk ofrohet ndonjë ndihmë nga komunat tjera që kjo strehimore i mbulon. Në vitin strehimorja përfitoi donacione *ad hok* nga komuna e Kamenicës dhe ajo e Vitisë, të barasvlershme me 1000 Euro secila.

Në Ferizaj, strehimorja nuk ka marrë fonde shtesë këtë vit përveç financimit nga MPMS-ja, (20.000 euro) si dhe grantit të trajnimit nga OJQ-ja "Save the Children". Në vitet e kaluara, është mbështetur kohë pas kohe me donacione nga komuna e Ferizajt (6.000 euro më 2016), Shtimes (500 euro më 2016) si dhe Kaçanikut (3.000 euro më 2014).

Situatë e ngjashme është shënuar në Prizren, ku strehimorja ka marrë 20.000 Euro nga MPMS-ja dhe 4.000 euro nga komuna; megjithatë, përkundër bashkëpunimit tejet të mirë me drejtorët e mirëqenies sociale të komunave fqinje, nuk është ofruar ndonjë mbështetje financiare nga këto komuna.

Strehimorja në Gjakovë, si gjetkë, pranon viktimat jo vetëm nga komuna përkatëse, por edhe nga Malisheva dhe Rahoveci; por, këto komuna nuk ndajnë fonde për përkrahje të strehimores, e cila kryesisht financohet nga MPMS-ja (30.000 Euro) si dhe komuna (2.000 Euro). Për shkak të prodhimtarisë vetanake të bukës dhe mjaltës, strehimorja arriti të funksiononte kur financimi nga MPMS-ja u ndërpre në fillim të vitit 2018.

Befasisht, strehimorja në Prishtinë është më së paku e financuar; strehimorja ka marrë licencën e ripërtërirë vetëm pas skadimit të afatit për aplikim për grante të MPMS-së; edhe më herët kjo strehimore ka pasur vështirësi në menaxhimin e brendshëm dhe probleme financiare, gjë që ka penguar mundësinë që të aplikohet për financim nga donatorët ndërkombëtarë. Përkundër faktit që pranon viktimat nga tetë komuna, ajo nuk përfiton asnjë mbështetje financiare nga ato komuna dhe prapë rrezikon të mbyllë dyert për viktimat e reja për shkak të borxhit prej 7,000 eurosh ndaj shërbimit të distribucionit të energjisë së Kosovës (KEDS).⁵⁹

⁵⁹ Sipas drejtores së strehimores në Prishtinë, arsyeja për faturat e mëdha të energjisë elektrike është që strehimoret kanë tarifa si biznese, e jo si ekonomi familjare, që duhet të jetë gjendja për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për individë të prekur nga dhuna. Shih: "Strehimorja e grave në rrezik për shkak të faturave të rrymës", tek "Pristina Insight", qasur më 10 dhjetor 2018.

Pasi që strehimorja në Novobërdë nuk është ende funksionale, nuk ka ndonjë mekanizëm të bashkëpunimit ndërkomunal që do të mbështeste funksionimin e saj; megjithatë, drejtorja e strehimores planifikon t'iu bëjë thirrje për bashkëpunim të gjitha komunave, e sidomos atyre me shumicë serbe, pasi të përfundojë procesi i licencimit.

Me qëllim të zgjidhjes së sfidave që kanë të bëjnë me financimin e qëndrueshëm të strehimoreve, më 25 qershor 2018, Koordinatori kundër dhunës në familje/Zëvendësministri i drejtësisë (Koordinatori) mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët, të organizuar nga OSBE-ja, për të trajtuar çështjet bashkë me përfaqësuesit e të gjitha strehimoreve. Koordinatori paraqiti plan me katër shtylla për përmirësimin e gjendjes së strehimoreve e që përfshinte: 1) vazhdimin e ciklit për aplikim për financim nga një në tre vite, që do të thotë se miratimi i fondeve do të ndodhte në të njëjtën kohë me ripërtëritjen e licencimit të OJQ-së së strehimores. Fondet më pas do të ndahen për çdo muaj; 2) krijimin e mekanizmave të rinj kundër dhunës në familje në Kosovë dhe funksionalizimin atyre ekzistuese, me qëllim të fuqizimit të mbështetjes financiare nga niveli komunal dhe rajonal; 3) ndryshimin e kornizës ligjore për ndihmë sociale që aktualisht nuk u lejon grave të cilat qëndrojnë në strehimore të marrin ndihmë sociale⁶⁰; 4) Kalimi nga ofrimi i pagesës paushall nga MPMS për strehimoret, siç është rasti tani, në financimin e strehimoreve në bazë të numrit të viktimave dhe shërbimeve të ofruara nga secila strehimore (pagesa sipas numrit të viktimave apo sipas shërbimeve të ofruara).

Plani i paraqitur nga koordinatori hasi në pajtimin e përgjithshëm nga të gjithë drejtorët e strehimoreve, të cilët njëzëri mbështetën ciklin e financimit trevjeçar që është i lidhur me aplikimin për licencim dhe me ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe rregullin për zbatimin e tij, me qëllim që t'ju mundësohet viktimave të cilat qëndrojnë në strehimore të marrin ndihmë sociale. Përveç kësaj, të gjithë kanë kërkuar krijimin e një linje të veçantë buxhetore në kuadër të buxhetit të MPMS vetëm për strehimoret, që do të ishte e ndarë nga OJQ-të tjera, dhe sugjeruan krijimin e buxhetit rezervë në rast të rritjes së papritur të pranimeve në strehimore. Për sa i përket pagesës në bazë të personave të pranuar apo shërbimit të ofruar, drejtori i strehimores në Gjilan përkrahu idenë, ndërsa drejtorët e strehimoreve në Novobërdë, Ferizaj dhe Mitrovicë Jugore e kundërshtuan atë me vendosmëri. Strehimoret gjithashtu kishin mendime kundërshtuese lidhur me pjesën e financimit të strehimoreve nga MPMS dhe komunat.⁶¹ Për shembull, drejtorët e strehimoreve në Gjilan dhe Prishtinë konsideronin

⁶⁰ Ligji nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë (ndryshuar me anë të Ligjit nr .04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Pjesa gjegjëse përcakton: 4.12. Personat që a) banojnë ose b) janë në institucione të tipit të mbyllur [...] nuk mund të përfitojnë ndihma sociale sipas këtij Ligji.

⁶¹ Informacioni është i bazuar në tryeza e rrumbullakët që është mbështetur nga OSBE-ja për financimin e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje, që është mbajtur më 25 qershor 2018, ku të pranishëm ishin koordinatori dhe drejtorët e të gjitha strehimoreve për viktimat e dhunës në familje në Kosovë.

se institucionet qeveritare dhe lokale duhet të ishin të vetmit financues që do të mbulonin 100 për qind të kostove operative të strehimoreve; drejtorët e strehimoreve në Gjakovë dhe Prizren avokuan për së paku 80 për qind të financimit nga këto institucione, ndërsa 20 për qind të mbulohet nga donatorët e jashtëm. Përveç financimit standard, strehimoret në Novobërdë dhe Ferizaj sugjeruan krijimin e një fondi emergjent që do të përdorej në rast të shtimit të papritur të viktimave që kërkojnë strehim.

Sidoqoftë, gjatë njërës prej takimeve të organizuar nga OSBE-ja⁶², koordinatori e pranoi se ekziston nevoja për krijimin e bazës më të mirë ligjore për strehimoret, por nuk e shtjelloi temën në lidhje me ndonjë prej shtyllave të lartcekura. Në vend të kësaj, ai theksoi rolin e institucioneve lokale për mbështetjen e ofruesve të shërbimeve sociale. Sipas tij, dhuna në familje nuk mund të trajtohet vetëm nga institucionet, dhe mekanizmat lokalë duhet të jenë më funksionalë në këtë fushë. Për këtë qëllim, ai sugjeroi se duhet të ndryshohet Ligji për financat e pushtetit lokal me qëllim që financimi i ofruesve të shërbimeve sociale, përfshirë strehimoret, të mbulohet nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal njëloj, ku secili nivel do të mbulonte 50 për qind. Në të njëjtën kohë, koordinatori theksoi rolin e ZKBGJ si koordinatore të mekanizmit komunal kundër dhunës në familje dhe tha se shtimi i kapaciteteve do të mund të përkthehej në shkallë më të lartë të rasteve të raportuara. Gjatë tryezës së rrumbullakët, koordinatori i informoi përfaqësuesit e strehimoreve se data për thirrjen për aplikime për grante është ndryshuar dhe se duke filluar nga muaji dhjetori ata mund të dërgojnë aplikimet e tyre për grantet e shërbimeve sociale në MPMS, me qëllim të marrjes së fondeve në janar.

Ndonëse financimi i strehimoreve është problem i madh për të siguruar punën e tyre në mënyrë të pandërprerë dhe ofrimin e ndihmës për viktimat në procesin e riintegritimit të tyre, ajo gjithashtu paraqet shqetësim lidhur me mospasjen e auditimit të rregullt të strehimoreve. Ndonëse të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale pritët që të bashkëpunojnë me zyrtarët e MPMS, përgjegjës për të monitoruar dhe inspektuar ofruesit e shërbimeve sociale⁶³, shumë organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të shoqërisë civile ranë dakord se procedurat e duhura të auditimit do të mund të rezultojnë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe në tërheqjen e më shumë donatorëve. Auditimi i rregullt i ofruesve të shërbimeve sociale, përfshirë strehimoret, do të përmirësonte mënyrën se si drejtohen strehimoret dhe se si shpërndahen të ardhurat me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre.

⁶² Informacioni është i bazuar në fjalimin e koordinatorit gjatë punëtorisë së mbështetur nga OSBE-ja për fuqizimin e kapaciteteve lokale për të trajtuar në mënyrë efektive dhunën në familje në Kosovë, që është mbajtur në Prishtinë më 22 nëntor 2018.

⁶³ Shih nenin 3, paragrafin 6 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, fusnota sipër 24.

Konstatime

Strehimoret për viktimat e dhunës në familje përbëjnë vetëm një hallkë në zinxhirin institucional përgjegjës për trajtimin e dukurisë negative të dhunës në familje; megjithatë ato luajnë një rol parësor në procesin e rehabilitimit dhe reintegrationit të viktimave në shoqëri. Në bazë të analizimit të kornizës ligjore dhe institucionale, si dhe intervistave me drejtorët e tetë strehimoreve, është fakt i pamohueshëm që vazhdon të ketë sfida serioze që pengojnë funksionalitetin e strehimoreve. Është e rëndësishme jetike që të sqarohen dispozitat për financim nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Legjislacioni për strehimoret duhet gjithashtu të harmonizohet dhe ato duhet të pranohen si pjesë e sistemit të drejtësisë e jo vetëm si ofrues të shërbimeve me status të OJQ-së.

Për sa i përket mekanizmave komunalë bashkërendues për mbrojtje nga dhuna në familje, vetëm 17 nga 38 komuna i kanë themeluar mekanizmat që konsiderohet se janë platforma kryesore për bashkëpunim në nivel lokal mes strehimoreve dhe aktorëve tjerë gjegjësisht për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Funksionalizimi i tyre varet shumë nga gatishmëria e kryesuesit dhe anëtarëve për të luajtur rol aktiv, duke marrë pjesë në mbledhje dhe duke ndërmarrë nismat e domosdoshme.

Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet procesit të licencimit të strehimoreve që drejtohen nga komunitetet joshumicë, kuadri i së cilave i ka fituar kredencialet e tyre profesionale jashtë Kosovës. Shumë gra nga komunitetet joshumicë, të cilat nuk e flasin gjuhën shqipe, përmbahen nga qëndrimi në ndonjërin prej strehimoreve në dispozicion në rast se bëhen viktima të dhunës në familje. Mungesa e strehimoreve për djemtë më të vjetër se moshë 12 vjeç dhe burrat është një lloj shqetësues.

Ekziston konsensus mes shumicës dërrmuese të atyre të cilët u intervistuan për këtë raport, se duhet të sigurohen trajnime të specializuara për personelin e strehimoreve. Këto trajnime duhet të përqendrohen në kornizën ligjore dhe të politikave për mbrojtje nga dhuna në familje dhe në programet e specializuara për trajtimin e punës së ngarkuar me stres dhe mjediseve emocionalisht të vështira.

Rekomandime

Mungesa e legjislacionit të harmonizuar që do të rregullonte statusin e strehimoreve mbetet sfida kryesore për funksionalizim të qëndrueshëm të strehimoreve për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Sidoqoftë, si masa të përkohshme, OSBE-ja jep rekomandimet në vijim për aktorët relevantë.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të mbështesë themelimin dhe kapacitetet e strehimoreve gjithandej Kosovës për të siguruar qasje kuptimplote për të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Të sigurojë ndarjen e financimit të duhur për strehimoret me kohë për çdo vit.
- Të përshtatet procesi i licencimit për të mundësuar njohjen e kredencialeve të profesionistëve të cilët janë përgatitur jashtë Kosovës.
- Të përcaktohen standarde minimale të përgatitjes për të gjitha kategoritë e specialistëve të cilët punojnë në strehimore.
- Të mundësohet trajnim për personelin e strehimoreve për të trajtuar punën e ngarkuar me stres dhe mjediset emocionalisht të vështira.
- Të mundësohet trajnim për kujdesin për viktimat të cilat kanë vështirësi me varësinë.
- Të zbatohet kushti për të siguruar shërbimet në të dyja gjuhët zyrtare në të gjitha strehimoret gjithandej Kosovës.
- Të mbështetet hartimi dhe zbatimi i strategjisë së riintegritimit për programin të përfshirjes sociale afatgjatë për të mbijetuarit e dhunës në familje.

Për Ministrinë e Drejtësisë/Koordinatorin për mbrojtje nga dhuna në familje

- Të themelohet model financimi i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm për strehimoret.
- Të propozohet kornizë ligjore e unifikuar për strehimoret.
- Në bashkëpunim me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të ofrohen trajnime për personelin e strehimoreve për kornizën ligjore dhe të politikave për mbrojtje nga dhuna në familje.
- Të vendosen procedura të rregullta, transparente dhe publike të auditimit për strehimoret.
- Të mbështeten mekanizmat komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje dhe të inkurajohen partneritetet ndërkomunale që mëtojnë të përkrahin strehimoret.
- Të mbështetet themelimi i mekanizmave komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje në ato komuna ku këto mekanizma nuk ekzistojnë,

Për institucionet e nivelit lokal

- Të inkurajohen strehimoret për të zhvilluar projektet e tyre për krijimin e të ardhurave vetanake që do të përmirësonin qëndrueshmërinë e tyre financiare.
- Të sigurohet disponueshmëria e banimit social që do të mund të shfrytëzohej për një periudhë kohore nga ana e viktimave të dhunës në familjes, pasi që ato të lëshojnë strehimoret dhe para se ato të bëhen plotësisht të pavaruara në kuptimin financiar.
- Të mbështeten në mënyrë aktive dhe të marrin pjesë në mekanizmat komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje, të fuqizohen zyrtarët komunalë për barazi gjinore në bashkë-kryesimin nga ana e tyre dhe të paraqiten raporte periodike për veprimtaritë e tyre, arritjet, sfidat dhe mbështetjen që nevojitet.
- Të vlerësohet nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të mekanizmave dhe të mbahen trajnime të zhvilluara enkas në bazë të nevojave.
- Të arrihet pajtim për formulën për ndarjen e kostos nga komunat.

Për strehimoret

- Të raportojnë rregullisht dhe saktë për të gjitha shpenzimet publike, përfshirë publikimin e buxhetit vjetor dhe raporteve të auditimit në mënyrë elektronike.
- Të sigurohen që informacioni bazik për mbështetje të viktimave të dhunës në familje të jetë në dispozicion në të dyja gjuhët zyrtare.
- Të zhvillohet bashkëpunim me zyrat për punësim dhe qendrat e aftësisimit profesional, si dhe me Qendrat për Punë Sociale me qëllim të ofrimit të trajnimeve të zhvilluara enkas dhe kurseve të zhvillimit profesional për viktimat e dhunës në familje, si pjesë e planeve të tyre për rehabilitim.
- Të ndërliqhen dhe bashkërendohen me institucionet lokale për nisjen e programeve për krijimin e të ardhurave që do të mbështesnin financiarisht strehimoret dhe që do të përmirësonin shkathhtësitë profesionale të viktimave.

Shtojca 1: Pasqyrë e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje në Kosovë

Komuna	Novobërdë	Gjakovë	Ferizaj	Prishtinë	Pejë	Gjilan	Prizren	Mitrovicë Jugore
Data e vizitës:	30.06.2018	02.08.2018	08.08.2018	16.08.2018	10.08.2018	06.08.2018	09.08.2018	14.08.2018
Tipi	Gjysmë e hapur	Gjysmë e hapur	I mbyllur	I mbyllur	Gjysmë i hapur	Gjysmë e hapur	Gjysmë e hapur	Gjysmë e hapur
Data e themelimit	2018	2000 (regjistruar në vitin 2002)	2014	2000	2001	1999	2002	2007
Hera e fundit kur është licencuar	Në vazhdimësi	2018	2017	2018	2017	2018	2018	2018
Numri i punonjësve (me orar të plotë, me gjysmë orari)	N/Z (në proces të licencimit të profesionistëve)	5 me orar të plotë (psikologu, pedagogu, drejtori, këshilltari, asistenti i projektit), 4 me gjysmë orari (2 këshilltar, avokati, furrtari)	6 me orar të plotë (2 gra në detyrë, drejtuesi, drejtori, zyrtari ligjor, këshilltari psiko-social); 4 me gjysmë orari (psikologu, sociologu, 2 zyrtarë administrativ-financiar)	6 me orar të plotë (drejtori, motra, 2 psikolog, 2 këshilltar); 1 me gjysmë orari (gjinekologu)	7 me orar të plotë; 3 me gjysmë orari (vullnetarë)	8 me orar të plotë (drejtori, zëvendës drejtori, koordinatori i projektit, 2 psikolog, 3 këshilltarë)	5 me orar të plotë (drejtori, 2 këshilltar psiko-social, motra, tekniku); 3 me gjysmë orari (psikologu klinik, 1 neuropsikolog dhe 1 zyrtar administrativ-financiar)	5 me orar të plotë (drejtori, 2 psikologë, asistenti, këshilltari); 1 me gjysmë orari (zyrtari administrativ-financiar)
Kapaciteti maksimal (përfshirë fëmijët)	16	15	15	19	18	15	15	15
Numri i banorëve në ditën e vizitës (përfshirë fëmijët dhe etninë)	N/Z	8 shqiptarë (f), 1 shqiptar (f), 3 shqiptarë dhe 3 fëmijë egjiptianë	1 shqiptar (f)	2 shqiptarë (f), 2 fëmijë	4 të rritur, 3 fëmijë	3 shqiptarë (f), 3 fëmijë shqiptarë	1 shqiptar (f)	3 shqiptarë (f), 2 fëmijë shqiptarë
Numri gjithsej i banorëve mes janarit dhe nëntorit të vitit 2018	N/Z	72	70	49	61	75	37	60
Qëndrimi maksimal	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj	6 muaj
Shërbimet e ofruara	Të planifikuara: strehim, veshmbathje, ushqim, përkrahje psiko-sociale, këshillim, punëtori zanati (floktari, kozmetologji, rrobaqepësi).	Strehimi, veshmbathja, përkrahja psiko-sociale, këshillimi, hartimin e planit të riintegrit për çdo viktimë në bashkërendim me Qendrën për Punë Sociale (QPS), arsim bazik dhe trajnime (TI dhe gjuhë), këshilla juridike; punëtori zanati, fushata ndërgjegjësimi, kujdesi për të moshuarit, bletari.	Strehim, veshmbathje, ushqim, përkrahja psiko-sociale, arsim bazik, trajnime (TI) dhe punëtori zanati.	Strehim, veshmbathje, ushqim, përkrahja psiko-sociale, arsim bazik, trajnime (TI) dhe punëtori zanati (rrobaqepësi).	Strehim, rehabilitim, kujdesi mjekësor, përkrahja psiko-sociale (këshillimi individual dhe në grup); kontaktet me anëtarët e familjes dhe përfaqësuesit e institucioneve gjegjëse; trajnime.	Strehim, veshmbathje, ushqim, rehabilitim, kontroll mjekësor, këshillim psikologjik individual dhe në grup, hartimi i planit të riintegrit për secilin person, trajnime (gjuhë, TI).	Strehim, veshmbathje, ushqim, rehabilitim, kontroll mjekësor, këshillim psikologjik individual dhe në grup, argëtim, sport dhe trajnime (TI dhe floktari).	Strehim, veshmbathje, ushqim, rehabilitim, kontroll mjekësor, këshillim psikologjik individual dhe në grup, hartimi i planit të riintegrit për secilin person, trajnime (rrobaqepësi, floktari).
Financimi [MPMS/komuna/të tjerë]	N/Z	MPMS (30.000 euro për çdo vit) + grantet nga organizatat e tjera + komuna (2000 euro këtë vit).	MPMS i pagoi 20.000 euro + grant nga "Save the Children" për ndërtim të kapaciteteve (15 ditë të trajnimit).	Vetëm MPMS (faturat e shërbimeve publike).	MPMS – 2500 euro në muaj (maj-dhjetor 2018). Komuna e Pejës - 3000 euro; komuna e Istogut – 1500 euro në vit.	MPMS i pagoi 20.000 euro dhe komuna i subvencionoi këtë vit me 5000 euro (mbuloi faturat e shërbimeve publike) + 20,000 euro grant nga OJQ "Save the Children".	MPMS (20.000 euro këtë vit) +komuna (4000 euro për faturat e shërbimeve publike).	MPMS 50% + MM mes Mitrovicë Jugore, Vushtrrisë dhe Skenderaj (nuk janë paguar ende) +komuna (500 euro).

Komuna	Novobërdë	Gjakovë	Ferizaj	Prishtinë	Pejë	Gjilan	Prizren	Mitrovicë Jugore
Mbështetja e dhënë nga bashkësia ndërkombëtare	UNMIK, KFOR, OSBE	Save the Children, Caritas Vjenë, UNDP, IOM, OJQ "RTM", KFOR, Christian Aid, UN Women, Ambasada e Holandës	Save the Children	Ambasada e Norvegjisë, Ambasada e Holandës, IOM, OJQ "RTM"	Ambasada e SHBA-ve, Ambasada e Gjermanisë, Shtabi i Përgjithshëm i KFOR-it, OJQ "CDF", Ministria e Shëndetësisë, Caritas Kosova	OJQ "ADA", Ambasada e SHBA-ve	Ambasada e SHBA-ve, EULEX, Ambasada e Holandës, USAID, KFOR-i Gjerman UNMIK, UNDP, UNFPA	OJQ "RTM", Ambasada e Zvicrës, Ambasada e Holandës, UNDP, IOM
Partneriteti me komunitat e tjera (P/J)	N/Z	Asnjë mbështetje financiare. Strehimorja mbulon komunitat Malishevë, Rahovec dhe Gjakovë.	Aktualisht nuk ka mbështetje financiare. Më herët, përkrahje financiare nga komunitat Hani i Elezit, Kaçaniku, Shtërpce dhe Shtime. MM u nënshkrua me drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Han të Elezit dhe Qendrat lokale për Punë Sociale.	Asnjë mbështetje financiare nga 8 komunitat që i mbulon strehimorja. Drejtori merr pjesë në mekanizmin komunal për bashkërendim për mbrojtje nga dhuna në familje në Lipjan dhe Glogoc.	Po. Përkrahje financiare nga komunitat Pejë, Klinë, Istog dhe Deçan.	Rrallëherë. Strehimorja i mbulon 10 komunitat që nuk e mbështesin atë financiarisht. Në vitin 2017, komuna e Kamenicë ndau (1000 euro donacion), më herët ishte komuna e Vitisë (1000 euro donacion).	Asnjë përkrahje financiare, por partneritet shumë i mirë me drejtorët për mirëqenie sociale nga të gjitha komunitat në rajonin e Prizrenit.	Po. MM u nënshkrua me komunitat Mitrovicë Jugore, Vushtrrisë dhe Skenderaj për të mbështetur 50% të shpenzimeve të strehimore në vitin 2018-2019.
Mekanizmi komunal për bashkërendim për mbrojtje nga dhuna në familje (P/J)	N/Z	I themeluar në vitin 2008 (OSBE), themeluar përsëri nga UN Women në vitin 2014.	I themeluar në vitin 2018.	I themeluar (OSBE) por nuk është funksional.	I themeluar në vitin 2015.	I themeluar në vitin 2011 (UN Women).	I themeluar në vitin 2014 (BE dhe OSBE), i themeluar përsëri në vitin 2018 (CDV).	I themeluar në Mitrovicë Jugore, por nuk është funksional për dallim nga mekanizmi në Skenderaj.
Bashkëpunimi me aktorët gjegjës [Policia e Kosovës, QPS, MV, shkollat, institucionet shëndetësore, etj.]	N/Z	Bashkëpunim shumë i mirë me Policinë e Kosovës dhe zyrtarët për punësim. Sfidat në bashkëpunimin me komunitat e tjera.	Bashkëpunim shumë i mirë me drejtorin për Shëndetësi, Qendrën për Punë Sociale, Policinë e Kosovës, mbrojtësit e viktimave, gjykatat, institucionet arsimore.	I mirë me të gjitha palët. Sfidat kanë të bëjnë me procedurat ligjore me Policinë e Kosovës dhe mbrojtësit e viktimave.	Bashkëpunim i rregullt me policinë, QPS, mbrojtësit e viktimave.	Bashkëpunim shumë i mirë me qendrat e mjekësisë, shkollat dhe sektorin privat. Nuk ka marrëveshje me komunitat për çështjen e banimit social.	Bashkëpunim shumë i mirë me të gjitha palët, posaçërisht me policinë.	Bashkëpunim shumë i mirë me Policinë e Kosovës. Sfidat në bashkëpunimin me QPS, për shkak të mungesës së një automjeti.
Sfidat kryesore	Procesi i licencimit, posaçërisht gjetja e profesionistëve me kredencialet që pranohen nga Kosova.	Financimi i paqëndrueshëm. Ri-hapja e furrës. Rivendosja e kosheres së bletëve. Mungesa e banimit social. Mungesa e vullnetit politik për ta mbështetur strehimoren.	Financimi i paqëndrueshëm. Bashkëpunimi i vështirësuar me QPS (mungesa e automjetit dhe e ndjeshmërisë për viktimat e DHF).	Mungesa e automjetit zyrtar. Asnjë trajnim profesional që nga viti 2013.	Mungesa e fondeve për organizimin e takimeve të rregullta të mekanizmit komunal për bashkërendim për mbrojtje nga DHF.	Financimi i paqëndrueshëm. Mungesa e përkrahjes nga komunitat e tjera. Sfidat me procesin e reintegritimit (mungesa e banimit social dhe vendeve të punës).	Financimi i paqëndrueshëm. Sfidat me procesin e reintegritimit (mungesa e banimit social dhe vendeve të punës). Paga shumë të ulëta.	Problemet me financimin e qëndrueshëm. Mungesa e objektit të tyre. Ndonjëherë, kryerësit i afrohen ndërtesës së strehimore, por largohen pas ndërhyrjes së policisë. Disa raste është dashur të refuzohen për shkak të mungesës së buxhetit.

Shtojca 2: Pasqyrë e mekanizmave komunalë për mbrojtje nga dhuna në familje⁶⁴

Nr.	Komuna	Viti i themelimit	Mbështetur nga	Funksional Po/Jo	Numri i takimeve	MM i nënshkruar	Kryesues i mekanizmit
1	Ferizaj	2018	OSBE	Po	3	Po	Nënkryetari Kryesia që ndërrohet për çdo vit
2	Gjilan	2013	UN Women	Pjesërisht	1 në vit	Po	ZKBJ
3	Hani i Elezit	2018	OSBE	Do të themelohet më 6 dhjetor 2018	N/Z	Do të nënshkruhet	N/Z
4	Viti	2015	OSBE	Jo	2 që nga viti 2015	Po	N/Z
5	Glllogovc	2014/ I formalizuar në vitin 2015	OSBE	Pjesërisht	2018 - 0; 2017 -1 2016 - 2; 2015-3	Po	Përfaqësuesi i QPS
6	Leposaviq	2016 Funksional në vitin 2018	UN Women	Po	3 në vitin 2018	Po	Zyrtari komunal
7	Mitrovicë Veriore	2016/2018	UN Women	Pjesërisht	3 në vitin 2018	Po	Zyrtari komunal
8	Zubin Potok	2016/2018	UN Women	Po	3 në vitin 2018	Po	Zyrtari komunal
9	Zveçan	2016/2018	UN Women	Po	3 në vitin 2018	Po	Zyrtari komunal
10	Skenderaj	2016	OSBE	Po	11 që nga themelimi	Po	ZKBJ
11	Gjakovë	2008/ i formalizuar në vitin 2012	UN Women	Po	30 që nga themelimi	Po	ZKBJ
12	Dragash	2012	UN Women	Po	30 që nga themelimi	Po	ZKBJ
13	Pejë	2015	Nismë e Qendrës për Mirëqenien e Grave	Pjesërisht	5 takime të rregullta (1-2 për çdo vit)	Po	ZKBJ dhe drejtuesi i qendrës për mirëqenie
14	Prizren	2014	Nismë e strehimores me përkrahje nga projekti i BE "Power"	Pjesërisht - i riaktivizuar në vitin 2018	7	Po	Po
15	Lipjan	2016	OSBE	Po	10	Po	Zyrtari i QPS
16	Obiliq	2018	OSBE	Po	1	Jo. Vendim i kryetarit të komunës.	ZKBJ
17	Prishtinë	2015	OSBE	Jo	7	Jo	ZKBJ

**Strehimoret
për viktimat
e dhunës
në familje
në Kosovë**

Janar, 2019